



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:138076
Datë: 31.03.2022
Numri i dokumentit: 02867290

C.nr.2049/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditësit S.N nga Gjilani, rr.”...” nr.3, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhavit Haziri avokat nga Vitia, Rr.”Adem Jashari” pa nr., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.B nga Prishtina, Zyrtar i Lartë Ligjor i Kompanisë, me objekt kontesti kompensim dëmim jo material, pas mbajtjes së shqyrtimi gjyqësor më datën 02.03.2022, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit S. N nga Gjilani, me të cilën kërkuar që të obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material t’ia paguaj shumën prej 1,500 € /njëmijë e pesëqindë euro/, për lëndime dhe dhembje trupore që ka pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 18.08.2020, me kamatë ligjore 8% duke filluar nga momenti i parashtrimit të padisë e gjer në pagesën definitive.

II. Secila palë bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë me datë 19.10.2020, nëpërmjet të autorizuarit të tij Xhavit Haziri avokat nga Vitia, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit jo material me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material t’ia paguaj shumën prej 1,500€ /njëmijë e pesëqindë euro/, për lëndime dhe dhembje trupore që ka pësuar në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur më datën 18.08.2020 rreth orës 12:00 në kryqëzimin e rrugës qarkore në Gjilan, nga automjeti i tipit “Fiat Dukato” me targa të regjistrimit ... Autoambulancë, të cilin automjetet e drejtonte Abdullah Maliqi nga Gjilani, i cili automjetet ka qenë i siguruar te e paditura, me kamatë ligjore prej 8% sipas dispozitave të nenit 26 paragrafi 1. pika 5 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, duke filluar nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Në përmbajtjen e padisë i njëjti ka theksuar se në aksidentin e trafikut që ka ndodhur më datën 18.08.2020 në rrugën e Ferizajit, te kryqëzimin në rrugën qarkore në Gjilan,

duke u bazuar në shiqimin e vendit të ngajrjes, deklaratave të drejtuesve dhe dëmtimit të automjeteve të përfshira në këtë aksident deri te aksidenti i trafikut ka ardhur atëherë kur Nj.”A” duke lëvizuar në shiritin e djathtë qarkullues fillon të bëjë kthim qarkullues në mënyrë të pasigurt duke mos i dhënë përparësi kalimi i mjeteve me përparësi kalimi NJ “B” autoambulancës, e cila ishte në vizitë emergjente e cila nuk ia ka përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës në kryqëzim me rrethrotullim, ku me pjesën e përparme të anës së majtë godet anësoren e pasme të anës së majtë NJ.”A”, ku me këtë rast shkakton aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore pëson paditësi Servet Nuredini, ku automjeti me të cilën është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguarur te e paditura, me nr.të polisës I dëmtuari gjatë gjithë kohës është shoqëruar me dhimbje dhe trauma të shkaktuara nga aksidentii e si rezultat i këtyre dhimbjeve ka pasur nevojë për kontrolla të vazhdueshme dhe specifike. I njëjti ka tentuar përmes të autorizuarit të tij që kjo çështje të rregullohet në procedurë jashtëgjyqësore, por që një kërkesë e tillë është refuzuar.

E paditura ka paraqitur përgjigje në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si për nga baza, ashtu edhe për nga lartësia e dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e datës 18.08.2020. Nga përshkrimi i aksidentit rezulton se paditësi i evidentuar në kolonën “A” në raportin policor është shkaktar dhe kontribues kryesor i shkaktimit të këtij aksidenti i cili në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor, duke mos e respektuar përparësinë e kalimit, veçanërisht ndaj mjetit me përparësi kalimi (autoambulancë në vozitje emergjente), godet automjetin “B” dhe kështu shkakton aksident trafiku, andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazaur.

Gjykata me qëllim të ekonomizimit të procedurës, në përpjekje që procedura gjyqësore të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, duke u bazuar ne nenin 420, parag. 3 të LPK-së, ka vendosur që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëher pas asaj përgatitore.

I autorizuari i paditësit si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 19.10.2020, por pretendimin e këtyre fakteve si prova i propozon gjykatës të shtjellohet edhe atë: Raporti i aksidentit ...i datës 18.08.2020, Raportin mjektësor i SP Gjilan-Emergjencia nr.prot.... i datës 18.08.2020, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan, Divizioni për kundërvajtje i datës 06.10.2020. Andaj në fund ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura që paditësit në emër të dëmit jomaterial t’ia paguaj shumën prej 1.500 €, për lëndime dhe dhimbje trupore që ka pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 18.08.2020, me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë. Po ashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104€, për përfaqësim në gjykatë shumën prej 135 € si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20€.

Përfaqësuesi i të paditurës si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe nga lartësia e saj. E paditura e njofton

gjykatën se në procedurë të rregullt e ka trajtuar kërkesën e palës paditëse dhe në bazë të provave është vërtetuar se vet paditësi siç është cekur edhe në raportin policor është shkaktar i këtij aksidenti pasi që i njëjti në kundërshtim me rregullat e Ligjit mbi Sigurimin e Komunikacionit Rrugor nuk i ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi pasi që kemi të bëjmë me autoambulancë e cila ka qenë në lëvizje emergjente dhe njëherit ka pasur të ndezuara dritat rrotative për paralajmërim se është duke kaluar një automjet me emergjencë dhe në këtë rast vozitësi i veturës “A” nuk e ka respektuar këtë detyrim ligjor dhe për këtë arsye ka ardhur deri te shkaktimi i aksidentit. Nisur nga dispozitat ligjore të Ligjit për Sigurimin e Autopërgjegjësisë nr.04/L-018 përkatësisht nenit 11 pika 1.1 thuhet se shkaktar i aksidentit përjashtohet nga mbulesa siguruese me çka të paditurës i mungon legjitimitet pasiv në këtë rast. Po ashtu i njëjti e ka kundërshtuar edhe provën-aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan-Divizioni për Kundërvajtje K.nr.892/20. Po ashtu sa i përket lartësisë së kërkesë padisë e ka kontestuar si të pabazuar pasi që në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë që të vërtetonte lartësinë dhe kategoritë e lëndimeve që ka pësuar paditësi nga ky aksident. Po ashtu i njëjti i ka kontestuar edhe shpenzimet e kërkuara nga i autorizuari i paditësit.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova materiale: Raporti i aksientit 2020-CR-... i datës 18.08.2020; Raporti mjekësor i SP Gjiilan-Emergjenca nr.protokolit ... datës 18.08.2020, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjiilan-Divizioni për kundërvajtje K.nr.... i datës 07.10.2020 si dhe Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit dorëzuar Gjykatës Themelore në Gjiilan-Divizioni për Kundërvajtje e datës 06.10.2020.

Në bazë të Raportit të aksidentit 2020-CR-... i datës 18.08.2020, gjykata vërtetoi faktin se është dyshuar se deri te aksidenti ka ardhur kur dy njësit më parë ishin duke lëvizuar në aksin rrugor Ferizaj-Gjiilan ku me të arritur në rreth rrotullim në rrugën qarkore, njësia “A” e cila ishte duke lëvizuar nëpër shiritin e djathtë qarkullues fillon të bëjë kthim gjysëm rrethor në mënyrë të pasigurt duke mos i dhënë përparësi kalimi mjeteve me përparësi kalimi Njësia “B” (autambulancës e cila ishte në vozitja emergjente) e cila nuk e përshatet shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës në kryqëzim në rrethrotullim ku me pjesën e përparme të anës së majtë godet në anësoren e pasme të anës së majtë Njësinë “A” dhe me këtë rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale në dy veturat, ndërsa ndihmë mjekësore ka kërkuar drejtuesi i njësisë “A”.

-Nga Raportit mjekësor i SP Gjiilan-emergjenca nr.protokolit ... dt.18.08.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësit i janë shkaktuar lëndime trupore, ku edhe i njëjti është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore pranë këtij Spitali.

-Nga Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit dorëzuar Gjykatës Themelore në Gjiilan-Divizioni për Kundërvajtje e dt.06.10.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi gjatë drejtimit të automejtit nuk e ka respektuar mjetin me përparësi kalimi-ambulancën në intervenim dhe tentim ndërrimi të shiritit të trafikut brenda rreth rrotullimit në momentin kritik i cili ka bërë lëshim primar, ndërsa njësia B-automjeti i autoambulancës ka bërë lëshim sekondar si mjet me përparsi kalimi të cilët kanë të drejtë të mos zbatojnë dispozitat e trafikut, kur janë në

intervennim, përveç në rastet kur me një veprim të tillë do të rrezikoheshin pjesmarrësit e tjerë në trafik. Me ç'rast është aksidentuar me njesinë A përtej vijes ndarëse të shiritave të trafikut në rrethrotullim (grykëta kësaj ekspertize ia falë besimin e plotë).

Me vlerësimin e provave të shtjelluara, secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku si dhe thëniet e palëve në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit të procedurës kontestimore, grykëta ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë ligjore dhe të njëjtën vendosi që t'a refuzojë në tërësi pasi që nuk është vërtetuar themelësia e saj meqë paditësi është shpallur fajtor dhe është denuar me denim Qortimi nga Divizioni për Kundërvajtje, dhe që nga ky moment i njëjti është përjashtuar nga mbulesa siguroese ashtu siq parashihet në nenin 11 pika 1.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia /Ligji nr.04/L-016/ ku parashihet se: *Me sigurimin e auto-përgjegjësive nuk ofrohet mbulesë siguroese dhe nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit drejtuesi i mjetit motorik i cili është përgjegjës për aksidentin*, andaj grykëta vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu grykëta në marrjen e këtij vendimi meritor u bazua në Procedurën Kontestimore nenin 319 I LPK-së par.1 i cili thotë se *"Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"*, dhe në nenin 322 par.1 i cili thotë se *"Në qoftë se grykëta në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e proves"* dhe 2 të LPK-së, i cili thotë se *"Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër"*, e ku në rastin konkret paditësi ka dështuar që të argumentojnë pretendimet e tije dhe për arsyet e lartëcekura grykëta vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Grykëta vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta gjyqësore, bazuar në nenin 450 të LPK, ku parashihet se secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta e po ashtu duke u nisur nga fakti që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës ndërsa paditësi i ka kërkuar por që e ka humbur procesin gjyqësor.

Andaj nga të lartëcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Grykëta Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 2049/2020, me datë 02.03.2022

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Grykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj grykëte.